



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1036/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Fitore Isufi , duke vendosur përkitazi me apelin e Simon Deda, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokratike e Kosovës (PSHDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Simon Deda, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokratike e Kosovës (PSHDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokratike e Kosovës (PSHDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, në Vendvotimet nr. 0211c/01R, 0211c/02D, 0205c/06R, 0205c/07R, 0205c/05r, 0224c/01R, 0224c/02R dhe 0224c/02R .

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Simon Deda, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik PSHDK, me të cilën kërkon që rinumërohen këto vendvotime: 0211c/01R, 0211c/02D, 0205c/06R, 0205c/07R, 0205c/05r, 0224c/01R, 0224c/02R dhe 0224c/02R. Më tej ka cekur edhe emrat dëshmitarëve të cilët e kanë votuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokratike e Kosovës (PSHDK) në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura paneli e miratoi apelin e apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze. Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.1036/2017 me datë 12.11.2017



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.